

VENDIM
Nr. 133, datë 7.4.2023

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 355, DATË 28.12.2022, “MBI MIRATIMIN PARAPRAK TË ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË ‘ALBGAZ’ SHA”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 47, pika 2, të ligjit nr. 102 /2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike me nr. 24/5 prot., datë 5.4.2023, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 355, datë 28.12.2022, “Mbi miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së ‘Albgaz’ sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 355, datë 28.12.2022, ndër të tjera, vendosi:

1. Të miratojë paraprakisht z. Elvis Ponari si Zyrtar të Përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a.

2. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga ky miratim, shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të depozitojë në ERE:

a) vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të “Albgaz” sh.a. për emërimin e z. Elvis Ponari;

b) kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë të nënshkruar mes “Albgaz” sh.a. dhe z. Elvis Ponari.

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimarrjen e mësipërme, me shkresën nr. 80 prot., datë 11.1.2023.

- Pas korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, rezulton se ajo ka depozituar dokumentacionin përkatës në përmbushje të kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit nr. 355/2022, si e tillë, kjo pikë duhet të shfuqizohet.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 355, datë 28.12.2023, “Mbi miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a.

2. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti